



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr 060/01-47438 dt. 20.09.2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **27.09.2023** (E Mërkurë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET

MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i datës 31.08.2023.
2. Propozim vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe parashikimi i buxhetit 2025-2026.
3. Raporti i Progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.
4. Propozim vendim për ndarjen e parcelave kadastrale.
5. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare.
6. Propozim vendim për miratimin e projekt rregullores të programit komunal tre vjeçar për banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit.
7. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit
8. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Drejtoria e Infrastruktues Publike.
9. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale.
10. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Drilona Krasniqit.
12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Vanesë Avdullahu.
13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valmire Xhema Krasniqi.
14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Shqiprim Hykolli.
15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Egzona Rustaj.

16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Kaltrina Gashi.
17. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Arton Hasani.
18. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Teuta Kuliqi.
19. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Ganimete Ramadani.
20. Të ndryshme.

Drenas, 20.09.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.09.2023, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe tri pika shtesë për rend ditë: 1. Raporti i progresit për Implementimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022. 2. Propozim vendim për bartjen e mjeteve financiare. 3. Propozim vendim për ndarjen e parcelave. Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota **“Për”**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i datës 24.08.2023.
2. Propozim vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe parashikimi i buxhetit 2025-2026.
3. Propozim vendim për miratimin e projekt rregullores të programit komunal tre vjeçar për banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogcit.
4. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit.
5. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
6. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Drilona Krasniqi.
7. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Vanesë Avdullahu.
8. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valmire Xhema Krasniqi.
9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Shqiprim Hykolli.
10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Egzona Rustaj.
11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Kaltrina Gashi.
12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Arton Hasani.
13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Teuta Kuliqi.
14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Ganimete Ramadani.
15. Të ndryshme.

Të gjitha këto propozim vendime u rekomanduan për mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal Drenas.

Të ndryshme.

Pati diskutime në interes të përgjithshëm të asamblesë komunale.

Drenas, 20.09.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr.- 060/01- 47439 dt. 20/09/ 2023

PROCESVERBALI

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **31.08.2023**
e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 25 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). **Mungoi Malsore Cakiqi, Bekim Lestrani, Labinot Halilaj, Hamit Kastrati, Jahir Hajdari, Muhamet Kurtaj.**

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt.27.07.2023.
2. Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
4. Raporti i punës Janar-Qershor 2023, i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Klubi i Hendbollit Drenica"
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "FC Liqeni"
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit "Klubi i Boksit Drenasi"
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Klubi i Futbollit" Feronikeli " Femra.
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV "Feronikeli" Meshkuj.
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, SHKA "Shotë Galica"
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV "Feronikeli Femrat"
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "SHKA SHQIPET E DRENICES"

13. Propozim Vendim për financimin e Projektit nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit “Kosova në dokumentet e qeverisë Amerikane 1945-99” gjatë vitit 2023.
14. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ” Fc Feronikeli 74”.
15. Propozim Vendim për financimin e Projektit OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ”KV Gryka”.
16. Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim .
17. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-39017, dt 09.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adenocarcinoma ductalis pancreatis, në shumën totale prej 1,600.00 euro.
18. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr. 06-070/01-41320, dt 21.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adem. Carcinom, dhe sëmundjes Arrest Kardio respirator, në shumën totale prej 1,600.00 euro.
19. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr. 01-070/01-0041969/23, dt 23.8.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer ovarian në shumën totale prej 1,600.00 euro.
20. Të ndryshme.

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, Përfaqësues të OSCE-së zyra e informimit**

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 31.08.2023, ku për diskutim ishin 20 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 27.07.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 27.07.2023.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, qeveria e ka dergu ligjin për faljen e tatimit në pronë, shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo me shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mehedin Salihu, a është fjala vetëm për njëqind (100) euro apo për krejt vitin dhe çka ndodh me ato subjekte që e kanë pagu tatimin për vitin 2023.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, qeveria ka bërë ligj për faljen e tatimit në pronë deri në njëqind (100) euro ndërsa ai që ka me pak se 100 euro ju falen krejt, ndërsa ai që ka më shumë vetëm 100 euro ju falen por jo më shumë, ndërsa ata që e kanë pagu rimbursohen vitin e ardhshëm. Falja e tatimit në pronë vlen vetëm për vitin 2023.

Mehedin Salihu, në një raport të E-Kosovës në tatim prunë janë të liruar familjet e dëshmoreve pse nuk ekziston një lirim i tillë edhe në Komunën e Drenasit, kur e dina se sa është numri i madh i familjeve të dëshmoreve.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tatimi në pronë dhe kush me e pagu dhe kush mos me e pagu, shumën e cakton Qeveria e Kosovës në bazë të shumës që e kemi përcaktu ne, sot e kemi edhe një pikë të rendit të ditës ku kërkojmë më ulë edhe më shumë përqindjen e pagesës të tatimit në pronë, tek pika tjetër.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.**

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, sa i përket normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 parashihi, Baza tatimore për tatimpaguesit me prona te paluajtshme brenda një komuna përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës se kombinuar të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit:

Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve si në vijim:

Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore mund të variojë prej 0.10% deri në 1%

Për vlerën e pronave mbi njëqind mije (100,000.00) aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20 %deri 1%, plus tatimi si nenit që e ceka me lart.

Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore q mund të variojë perj 0.40% deri në 1% .

Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri1%

Për vlerën e pronave mbi pese milion (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50 % deri 1%.

Vlerësimi i objekteve ka me u bërë këtë vit për vitin 2024.

Sa i përket shkalleve ne kemi shku ne shkallen me të ulet të cilën e parasheh ligji që me i kursy qytetaret tanë.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Raporti i punës Janar-Qershor 2023, i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket raportit për periudhën raportuese Janar-Qershor 2023 në zyrën e kryetarit janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm 1161 lënde të ndryshme, ku prej tyre 814 janë miratuar, 310 jon në proces për shkak të afateve kohore, 29 janë refuzuar, janë anuluar, 2 janë cekur ne drejtori tjera dhe 1 hedhur poshtë.

Të gjitha lëndet janë proceduar me kohë, ndërsa janë kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit, janë nxjerr 159 vendime të ndryshme, ku ato kanë pasur karakterin e përgjithshëm, janë publikuar në ueb faqen e Komunës si dhe çdo muaj në formatin Ëord, janë listat e vendimeve dhe të njëjtat janë dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për të diskutuar e raportuar aktivitetet e gjashtë mujori të parë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitë synimet dhe investimet kapitale. Po ashtu është mbajtur një dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft-Kornizën Afatmesme buxhetore 2024-2026 për kërkesat fillestare më qytetaret e Komunës së Drenasit. Po ashtu janë mbajur edhe tri mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, janë mbajtur 26 mbledhje të brdit të Drejtoreve, ku janë diskutuar pika të ndryshme dhe për të gjitha është mbajtur proces mbi diskutimet dhe konkluzionet e ndjerra nga mbledhjet, ku secili drejtori në baza javore ka raportuar për aktivitetet, punët dhe angazhimet si janë diskutuar temat të ndryshme. Te gjitha njoftimet, ftesat, dhe dokumentet e tjera janë të publikuara në ueb faqën të komunës dhe ne rrjetin social facebook.

Kryetari i Komunës gjatë kësaj periudhë raportuese ka nënshkruar 16 memorandume të bashkëpunimit me ministri të linjës dhe organizata ndërkombëtarë për të realizuar projekte të ndryshme në të mirën e qytetareve. Të gjitha këto memorandume, janë publikuar në ueb faqen e komunës zyrtare dhe janë të qasshme për të gjithë të interesuarit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Hendbollit Drenica”**

Florentina Elezi-Veliu, pati dy qeshtje: për projektet të cilat nuk janë subvencionuar nuk është asnjë arsye pse nuk i kanë fitua subvencionet ato projekte?

Kërkesa e dytë është për për financimin e Projektit OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “KV Gryka” i kanë kërkuar 5.000 euro ndërsa i keni subvencionuar vetëm me 2500 kërkesë e jona është me e rrit ketë shifër nëse ka mundësi.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, “KV Gryka” kur ka qenë në rend të njëjtë me klubet tjera të njëjtit sport e ka pas subvencionimin e njëjtë, kriteret i ka përcaktuar me rregullore Kuvendi i Komunës dhe janë të obliguar komisioni profesional i cili u përcaktua, komisioni i bën propozimet, kuvendi në këtë rast nuk propozon as me shtu as me e zvogëlu shumën për subvencionim të një klubi apo të një klubi tjetër, kuvendi e miraton një propozim të komisionit apo e hedh poshtë, për të gjitha propozimet nga pika e pestë deri tek pika e pesëmbëdhjetë diskutohet apo mos të votohet, gjithçka ka qenë transparente ka qenë publike, ka qenë njoftim zyrtar dhe e kanë pas kohën e ankesave, ata që nuk i kane plotësua kriteret, ato klube që nuk janë subvencionua ose janë në listë por janë nën 1500 € dhe i nënshkruan vetëm kryetari.

Arbër Halilaj, sa i përket pikës që është diskutuar të subvencionimeve krejt çka pata kërkuar është transparenca në aspektin e prezantimit të informacioneve shitesë sa i përket kërkesave. Meqë po flasim për projekte dhe meqenëse këto na janë prezantuar si dhe i ka shqyrtu

komisioni duke pas parasysh rëndësinë e sportit për një komunitet, si dhe prezantimi që na bëjnë qoftë në arenën kombëtare apo ndërkombëtare, si dhe rëndësinë e mirëqenies së një komuniteti unë jam për të gjitha propozimet të kalojnë dhe natyrisht dhe shumat nuk janë të mjaftueshme prej disa prej tyre mirëpo në suaza të buxhetit të komunës mendoj se të gjitha propozimet duhet votohen.

Hamit Haxhiu, “KV Gryka” i ka kërkuar 15,460.00 € i ke të specifikume furnizim me veshmbathje 5400 €, mbledhje të procesmbajtësit transporti ndërsa subvencionimi është diku 2500 €, unë kam diskutuar me të gjitha klubet thuajse dhe e kam shiku se sa kanë aplikuar për subvencionim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë nuk e di ku i ke shiku ti raportet mirëpo unë sipas informimit të drejtorisë janë diku shpenzime të tyre që i kanë paraqit, është prezent anëtarë i komisionit që mund të raportoj para jush për çdo informacion.

Egzona Tërdevci, e kemi shikur listën e subvencioneve që është dhënë dhe sa kemi parë nga thirrja fillestrare ka mbetje prej të gjitha kategorive, drejtoria kulturës 6500 euro ka mbetje tek rinia që është shumë shqetësuese që nuk kam parë asnjë aplikim për subvencione për fushën e rinisë pra 2000 euro kanë qenë të destinuara të gjitha janë mbetje dhe ka mbetje tek fusha e sportit 7000 euro, kërkesa e koleges Florentina për me është shumë “KV Gryka” u bazua pikërisht në faktin se e dina që ka mjete që kanë tepër e kuptojmë që është ligen e tretë e kemi shiku kategorizimin e klubeve por ndoshta një subvencionim shtese prej komunës kish me i ndihmu një klub që na përfaqëson neve me kalu në një lig tjetër. Po ashtu po e bej si kërkesë publike raportet financiare kur dorëzohen për këtë subvencionim le të vijmë edhe tek ne si Kuvend Komunal, meqë vendimi po merret nga ne për subvencionim kur vie raporti i atyre mjeteve ju lutem adresone edhe tek ne si Kuvend Komunal. Si dhe për çështjen e ndarjeve të subvencioneve unë e kam lexu edhe rregulloren dhe nuk kam shikuar që duhet patjetër me kalu nga Kuvendi Komunal mundet me u dhënë edhe nga kryetari kështu është edhe praktik edhe në komunat tjera kërkoj një sqarim edhe për këtë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, komisioni ka vendos dhe nuk kemi mundësi me shtu ose me heq diçka, raportet financiare përveç që janë publike ia kemi dërguar edhe juve me email, pas viti të ri janë të obliguar me ligj me raportu, nëse nuk raportojnë ne jemi të detyruar me e dërgua në hetime, sa i përket çështjes së ndarjes së subvencioneve une e kam dërguar rregulloren në kuvend që kryetari i komunës mos me pas të drejt me subvencionua asnjë cent, kryetaret e komunave tjera e kanë edhe 50 mijë euro subvencionojnë une e kam dergu me zero dhe MAPL-ja na ka kthyer që nuk bën se paku nën 1500 euro për shkak të nevojave emergjente, prandaj është komisioni komunal që e bene vlerësimin.

Beqir Kiqina, sa i përket subvencionimit të klubit OJQ-ve dhe gjithë atyre organizatave që kanë aplikuar kështu është një përgjigje nga Drejtoresha e Kulturës Rinisë dhe Sportit komisioni gjitha kriteret janë përcaktuar nga ligji apo udhëzimi administrativ apo si, dhe përqindja a është e barabartë për të gjitha klubet apo ka një diferencë këtu?

Enkela Dema- Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport, sa i përket pyetjes rreth subvencionimit të klubeve dhe përqindjes së subvencionimit të klubeve sipas rregullores komisioni ka marrë vendim për subvencionimin e këtyre klubeve, përkatësisht kemi të bëjmë me ndarjen e kategorive të cilat ato veprojnë.

Egzona Tërdevci, e adresova edhe me herët që është shqetësueses që nuk ka asnjë aplikim prej rinisë a ka ndonjë organizatë rinore, që është aktive në qytet?

Laureta Thaqi- Drejtoreshe për administratë të përgjithshëm- lidhur me projektin Komuna për të rinjtë që e kemi fituari nga granti i performances se mire që i dedikohet të rinjve, ne fazën e parë fatkeqësisht nuk ka pasur shumë interesim të rinjve për të qenë përfitues. Pavarësisht se jemi munduar dhe ka qenë një mundësi e mire për shkak se kanë pas mundësi aplikimi dhe përfitimi të rinjtë dhe organizatat që përfaqësohen nga të rinjtë. Shumat e financimit kanë qenë për adoleshentë deri 6 mijë dollarë, ndërsa për të rinjtë e moshës nga 18-24 deri në 15 mijë dollarë. Ka disa nga përfituesit që i kanë kthyer mjetet, hiç me larg javën e kaluar nga thesari me kanë njoftuar dhe kanë kërkuar se në cilin kod buxhetor me bo kthimin e mjeteve, participimit tone të ky përfitues. Ka edhe tjerë që janë në proces kthimit, disa nuk i kanë perfunduar akoma, e disa i kanë finalizuar. Sakte me shifra nuk i di dikund 7 i kanë perfunduar, total përfitues janë 16. E vetëm 1 përfitues me ma raportuar deri tani që e ka perfunduar projektin, me raport narrativ e financiar. Por e kemi fazën e dytë, jemi në proces dhe shpresojmë të këtë aplikues, interesim me të madh të rinjve dhe t'i realizojnë projektet.

Mergim Pirraku, e pati një kërkesë nga Klubi i shahut të Drenasit, Shqipëria për vitin 2023 e ka të drejtën e organizimit për ngjarjen me të madhe që i përket këtij sporti, d.m.th. kanë me e organizua kupën e klubeve në Evropë të drejtën për pjesëmarrje e ka edhe klubi nga qyteti jonë që e mban emrin "Drenasi" ata kanë gjet mënyra për me i financua shpenzimet që i kanë për pjesëmarrje mirëpo nuk kanë mundur me e gjet asnjë sponsor kërkojnë nga ne që ta diskutojmë mundësinë me përkrah klubin për pjesëmarrje, ngjarja do të zhvillohet gjatë muajit shtator, unë mendoj që është ngjarje tejet e rëndësishme dhe besoj se ne duhet me e gjet mundësinë dhe me përkrah klubin.

Kryetari Komunës Ramiz Lladrovci, mjetet që kanë mbet të lira sigurisht që ne kemi interes me shpenzu sepse ato humbin Klubi i shahut "Drenasi" nuk i ka plotësua kriteret, kemi me e shiku mundësinë qoftë me donator qoftë nga buxheti komunës.

Albulena Saliuku, meqenëse komisioni e ka bërë vlerësimin për këto subvencione dhe çdo gjë po duket që është transparente vetëm se me ju uru suksese klubeve dhe sa herë që kemi propozime të tilla gjithmonë do ta këtë përkrahjen time.

Mehedin Salihi- pse nuk wshtw subvencionua libri i autorit Nustret Pllana ku në atë libër janë fëmijët e masakruar të Komunës së Drenasit janë me emër mbiemër dhe foto.

Kryetari Komunës Ramiz Lladrovci, rregullorja e Komunës së Drenasit nuk subvencionon asnjë person asnjë institucion, asnjë OJQ jashtë Komunës së Drenasit, ne i financojmë vetëm qytetaret e Komunës sonë, dhe rregullorja e ka përjashtua atë jo ne.

Hamit Haxhiu, unë nuk isha në dijeni që asht anëtar i komisionit prezent para se ne me diskutu u dasht me na njoftu rreth subvencionimit të klubeve se për arsye ne kemi kërkuar që me qenë njeri prej anëtareve të komisionit dhe me na raportu se si është bërë subvencionimi i klubeve, meqë asht këtu kërkoj një sqarim.

Kryetari Komunës Ramiz Lladrovci, komisioni ka ardh me sqarime me të detajuara, na thuaj një detaj të cilin po kërkon përgjigje, por mos na merrni kohë për raport sepse raportin e keni në email për çdo person që ka aplikua për subvencion, i votoni apo jo është në dorën tuaj,

Hamit Haxhiu, drejtoresha e ceki që klubet të cilat avancojnë në liga duhet me qenë subvencionimi më i madh, ka ndodh me herët, ka pasur klub që kanë garu nëpër liga më të larta subvencionimi vitin e kaluar ka qenë me i vogël dhe tash ka rënë nga liga dhe subvencionimi është ma i madh, dhe sipas udhëzimit administrativ thotë që asnjë klub nuk ka të drejtë me u subvencionua në qoftë se të paktën një vit nuk e ka aktivitetin sportiv, e dyta tek projektet mbrëmë i keni dërgu pas orës 6 dhe unë i kam kërkuar që një muaj e gjysmë speci kimet e klubeve, ne jemi me i përkrah dhe me i mbështet klubet tona por le te jete një subvencionim në rregull.

Kryetari Komunës Ramiz Lladrovci, komuna është në një kategori më të ulët nuk ka kategoria e tretë me te parën me e marr njëjtë sepse as nuk i ka shpenzimet e njëjta as nuk i ka lojtarët që paguhen njëjtë d.m.th. është dallim i madh prandaj kategoritë luftojnë klubet që me qenë në kategori me te lartë. Asnjë OJQ që nuk e ka veprimtarinë një vjeçare nuk ka fitu dhe nuk fiton subvencion në Komunën e Drenasit, “Feronikeli” vitin e kaluar nuk ka fitua asnjë cent sepse nuk e ka pas themelimin një vjeçar prandaj është vetëm këtë vit, i falënderojmë gjithë ata që janë angazhua qofte edhe donatorët që e kanë kthye ne super lig.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 2 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “FC Liqeni”**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit “Klubi i Boksit Drenasi”**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Futbollit” Feronikeli “ Femra.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV “Feronikeli” Meshkuj.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, SHKA "Shotë Galica"**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, (Për) votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV "Feronikeli Femrat"**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, (Për) votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "SHKA SHQIPET E DRENICES"**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, (Për) votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: **13. Propozim Vendim për financimin e Projektit nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit "Kosova në dokumentet e qeverise Amerikane 1945-99" gjatë vitit 2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, (Për) votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërbëdhjetë të rendit të ditës: **14. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Fc Feronikeli 74".**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, (Për) votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **15. Propozim Vendim për financimin e Projektit OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "KV Gryka".**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar, (Për) votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negocim .**

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, me propozim të Kryetari të Drenasit, Kuvendi në mbledhjen e mbajtur me 27.07.2023 ka nxjerr vendimin për krijimin e komisionit I cili do ta

ndihmoj dhe rekomandoj Kryetari të Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhenien e pronave me negocim me dt 07.08.2023 komisioni në përbërje të Arben Shalës, Bekim Lestranit dhe Albulena Saliukut, Hamit Haxhiut dhe Beqir Kiqinës wshtw mbledhur në sallën e bordit dhe kanë diskutuar për dy kërkesat e pranuar që janë nga TDI Ballkans për dhënien në shfrytëzim të tri ngastrave me sipërfaqe të përgjithshme 56 hektar nw Komoran. Komisioni nxori konkluzionet e mëposhtme:

1 TDI Balkans

- Sipërfaqja e përlogaritur për të tri parcelat është 56 ha.
- Është tokë e klasit të 6-të, për momentin e pashfrytëzuar.
- Kjo nuk angazhon numër të madh të punëtorëve por përfitimi nga qiraja është i kënaqshëm për komunën, mbi 750 euro për hektar.
- Në kërkesë kërkohet parcela P – 70314035-01317-0, përderisa në listën e lokacioneve të mundshme për investim në Komunën e Drenasit, kjo parcelë figuron me numrin P – 70314035-01317-1. Kërkohet që të kihet vëmendje për këtë çështje dhe të përmirësohet. Në mënyrë unanime komisioni rekomandoi që kërkesa e lartpërmendur nga TDI të merret në konsideratë pozitivisht, respektivisht të aprovohet kërkesa e tyre duke marrë parasysh çështjet e lartpërmendura.

2. Frida's Farm

- Sipërfaqja fillestare e kërkuar është 20ha me mundësi zgjerimi edhe për 40-50 të tjera.
- Me këtë përfitimi i komunës është në numrin e të punësuarve, përderisa sa i përket pagesës për shfrytëzim të pronës, komisioni aprovoi opsionin e dytë për qira vjetore prej 319 euro në vit.
- Komisioni tërheq vëmendjen se pas 20 ha të parë mund të ketë vështirësi në sigurimin e hektarëve tjerë pasi që nëse në ndërkohë vjen një ofertë e kënaqshme, mund të jepen në shfrytëzim e jo të pritet pas vitit të 5 që Frida's Farm e kërkon. Në mënyrë unanime komisioni rekomandoi që kërkesa e lartpërmendur nga Frida's Farm të merret në konsideratë pozitivisht, respektivisht të aprovohet kërkesa e tyre duke marrë parasysh çështjet e lartpërmendura.

Egzona Tërdevci- më intereson për TDI Ballkanas qysh mundeni me dhënë me qera një pronë kur nuk dimë për sa vjet se këtu po thuhet që është e papërcaktuar. Në bazë të kërkesës po e kuptojmë që behët fjalë për një tokë në Komoran, por kërkesa e dytë ku është toka që ka me u dha në shfrytëzim se nuk është e cekne të kërkesa Fridas Farm.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala- sa i përket pjesës së parë duhet ta shikojmë edhe një herë raportin sa i përket pyetjes së dytë është në fshatin Sankoc.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Nuk ka dhënë të pronës pa përcaktim kohor që ta kem të qartë nëse nuk gaboj kem të drejt mbi 15 vite deri në 99 vite me dhanë me qera, nëse këtë raport ju e aprovon unë mundem me bërë marrëveshje me kompanitë në fjalë edhe muajin tjetër me prur propozim vendimin pra me krejt këto që komisioni i ka shqyrtu prandaj edhe kom kërku që ju me dhënë rekomandime kjo është në interes të Komunës se ju e aprovon raportin në mbledhjen tjetër unë muj me prur propozim vendimin me votu në Kuvend

Mergim Pirraku- a ka mundësi me na tregu për historikun e projektit për investitorin Fridas Farm me na tregu se a punojnë edhe dikund tjetër edhe a kanë jep një raport.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala- në bazë të dokumenteve që i kanë sjell, ata kanë një përvojë të gjatë tash vinë në bashkëpunim me disa investitor nga Maqedonia.

Egzona Tërdevci- Afati nuk qenka as të Frida Farm ndoshta ju e dini po këtu nuk është i shkruar në kërkesë afati veç është i shkruar deri në 5 vite, mandej mundet me kërku prapë shtesa. Tash a është 5 vite krejt koha që ka kërku pronën a sa? Unë i lexova opsionet që më e lavdishme u kanë mi dhënë 10.000 euro në vite për më financim të një aktiviteti kulturorë apo sportive se nëse shkojmë me 319 për 20 hektar po i bie që është 6.300 € qeraja.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Kompania e rritjes së shpezëve e rritjes së pulave është një prej kompanive më të fuqishme që bashkëpunojmë me holandezet në botë, brendi ka me dal made in Kosova krejt për tregun e jashtëm ata kanë thënë pas 5 vite sepse ata nuk vinë me investua edhe me u ndal pas 5 vite në qoftë se ne kemi nevojë me u rrit me na dhënë mundësin me pas pronë, unë nuk jam në dijeni se komisioni i ka negocu. Unë nuk jepi pronë nën 15 vite as mbi 99 vite, 160 persona janë punësu plus ato janë fitimet që i ka edhe Kosova edhe Komuna me dërgimin e eksportit të mishit të shpezëve .

Nënëkryetari i Komunës Arben Shala- sa i përket sponsorizimit kemi mendu që ligji i sponsorizimit mund të vlej edhe për këtë kompani edhe mund të sponsorizoj edhe këtë do të thotë ky është një sponsorizim shtesë përveç kësaj në qoftë se edhe ata dojn me sponsorizu ndonjë aktivitet.

Beqir Kiqina- sa i përket këtij komisionit ku edhe unë jam pjesë, për dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës së Drenasit, me sa e di Drejtori i Arsimit z. Gjoka ka qenë në takimin kur është diskutu kisha pas dëshirë me na e dhënë një sqarim që kur të vjen propozim vendimi besoj ma mirë kishim mujt me elaboru.

Hamit Haxhiu- Kompania e kësaj ferme të pulave investimi është 8 milion, klasa e tokës është klasë e 6 është 319 euro për hektar në vit dy vitet e para është pa qera është faza e investimit përkrahje për Komunën deri në 10.000 euro në vit punëtorët deri në fazën kur fillon do të jen 160 punëtor është për 40 vite, ndërsa për pjesën e dytë që është TDI është me solar vlera është 29.5 milion investim shkon dikun deri në 56 hektar domethënë komuna e fiton 1 megavat në vit për një megavat fiton 1000 euro këtu llogaritet me kan 42.5 megavat në vit. Punëtorët gjatë punës janë objektivisht 20 punëtor pas ndërtimit do të jen dy deri në katër punëtor, investimi total është 42 milion.

Egzona Tërdevci- mendoj që janë të pa përcaktune në kërkesë, kërkesa nga TDI në fund është në Komoran II për vendosjen e paneleve solare në kohëzgjatje të papërcaktuar në kërkesë, as të Frida nuk është e cekne. Kërkoj ta rregulloni.

Hamit Haxhiu- sa i përket këtyre izraelitëve me solar këta janë kanë kur është mbajt një dëgjim publik edhe kemi diskutu komplet për këtë pikë, kështu që ke ndonjë vrenjtje paraqite po jam kanë këtu edhe kemi diskutu direct me investitorët.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- unë po mendoj që kuvendi duhet me ju dhënë një rekomandim ju i keni përzgjedh anëtarët asnjë prej anëtarëve tu juaj nuk u kanë kundër prandaj po kërkoj një miratim formal, me ato defekte që i tham edhe ju edhe unë.

Egzona Tërdevci- pak e pakuptimte që secilën here që komisioni bën një raport me ardh me u votu në kuvend përderisa ne ju kemi dhënë si kuvend besimin këtij komisioni po ju si ta shihni të arsyeshme.

Arbër Halilaj- nuk kom pas mundësi me marr pjesë në komision po në KPF e kam cek që jam gjithmonë pro që ti aprovojme investitorët e jashtëm projektet e këtilla sidomos ky që ka të bëjë me energji të ripërtitshme po edhe projekti i Frides Farm hyn në resorin e bujqësisë që Komuna e jonë është e përshtatshme për këtë veprimtari, mendoj që parimisht duhet t'i kalojmë këto dy propozime ndërsa gabimet eventuale le të përmissohen për në propozim vendim kur të vjen për votim përderisa gjithë kemi qen edhe e kemi pas gojën plot që do të sjellim investitor të jashtëm, unë jam që të vazhdohet me procedura.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-39017, dt 09.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adenocarcinoma ductalis pancreatis, në shumën totale prej 1,600.00 euro.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, po du me ju dërgu mesazh të gjithë qytetarëve të gjitha mjetet që janë kanë për subvencionim për raste emergjente Drejtoria e Shëndetësisë e Mirëqenës Sociale i ka hargju këto të fundit janë që e kam unë edhe prej fondit të zyrës së Kryetarit, nuk kemi më mjete që gjithë ata që aplikojnë ta dinë që ne nuk kemi mundësi me i ndihmu, kemi ba një gabim që kemi subvencionu nevojtarët e sëmundjeve të rënda por që nuk e kemi llogarit mirë, këto janë të fundit që i kem për miratim për këtë vit.

Egzona Tërdevci- konsideroj që kemi nuk kemi bërë diçka gabim veç kemi bërë mirë që ju kemi dal në ndihmë, mujm me pa mundësi alternative me ba ndonjë bartje të buxhetit se është muaji Gusht edhe 4 muaj mundemi me pas kërkesa deri tash krejt kërkesat që kan ardh përmes kuvendit komunal janë kanë të arsyeshme edhe krejt sëmundje të cilat është vështir me i përballu me buxhete familjare që i ka secili prej qytetarëve.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- nuk e kemi prit që ka me pas kërkesa kaq shumë aj është gabimi nevojtarët i kemi mbështet po ne e kemi shpenzu buxhetin mendoj që duhet me qen ma të kujdesshëm për me pas shuma më të vogla për me mujt me qu deri në fund të vitit.

Mehedin Salihu- deshta me u ndërlidh me atë se çka do të bëjmë me aplikantë të tjerë, dukë e ditur që numri i tyre sëmundje është i madh, ma në pozit të keqe dalim nëse i refuzojmë ata patjetër duhet ta mendojmë ndonjë alternative tjetër se ka me pas numër të madh.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ne e kemi obligim me ju dal në ndihmë sa kemi mundësi edhe sa kemi buxhet, kodi për subvencionim është në shumën e përcaktuar të cilët na jemi duke e shpenzu të gjithë të prekurit me kancer subvencionohet edhe nga niveli qendror kemi me i kërku edhe nivelit qendror që pacientet tonë me pas parasysh.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, **(Për)** votuan 22 anëtar, kundëri nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-41320, dt 21.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adem. Carcinom, dhe sëmundjes Arrest Kardio respirator, në shumën totale prej 1,600.00 euro.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, **(Për)** votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës: 19. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 01-070/01-0041969/23, dt 23.8.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer ovarian në shumën totale prej 1,600.00 euro.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, **(Për)** votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëzet të rendit të ditës: 20. Të ndryshme.

Egzona Tërdevci- kam disa pyetje tek investimet kapitale te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit është paraparë një Projekt këndi i lojërave për fëmijë në vlerë 10.000 euro po nuk është e cekne në cilin fshat ose në qytet ku do të bëhet, po ashtu është një projekt tjetër gjelbërimi i hapësirave në vlerë 40.000 euro edhe ky nuk ka vend të destimum se ku do të bëhet, tek Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale, tek Qendra për Punë Sociale janë parapa vetura zyrtare 60.000 euro sa vetura kanë me qenë edhe cila është nevoja për gjitha këto mjete, tek QPS që të adresohen tek veturat zyrtare. Të Arsimit është ndërtimi i shkollës së re në Shtrubullova ndërtimi i shkollës Rasim Kiqina tash koka ba në Shtrubullova po është shumë shumë e vogël janë nda vetëm 25.000 euro nëse mundet me u sqaru pse kaq pak mjete?

Shyqiri Bublaku- çdo projekt capital i cili shkon për aprovim gjë që vjen edhe te ju pa u specifiku ku ka me u ndërtu nuk mundet me kalu se na jeshin mjetet në rezervë buxhetore dhe nuk mund të aprovohet jem tuj shqyrtu kërkesat e secili ka me u specifiku, ndërtimi i shkollës fillore ka me u ban në Shtrubullova po aje ka me qen njësi e shkollës Rasim Kiqina. Edhe të projektet tjera që i ceke kanë me qen të njëjta bahet specifikimi

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- për shkollë aja fillimisht duhet me kanë njësi po adit që të ndërtohet ti plotson kriteret I ka mbi 170 nxënës ajo bëhet shkollë e pavarur me emër të pavarur faleminderit.

Shyqiri Bublaku- edhe njëherë pe ceki asnjë projekt capital nuk mund të shtihet në programin PIP Programi I Investimeve Publike pa u specifiku, ato kam me ardh te ju me u specifiku nëse nuk aprovohen në kuvend komunal para 30 Shtatorit ka me ardh në kuvend edhe lista e projekteve kapitale e specifikume mu aprovu këtu dhe përcillet për Ministri të Financave.

Drin Halilaj- aty ku u parapa ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit 200.000 euro i kam dy pyetje a janë të mjaftueshme së pari edhe cilët fshatra do të furnizohen. Edhe të kultura renovimi i objekteve sportive 20.000 euro, nëse ban me dit cilat objekte do të renovohen, ndërtimi i objekteve sportive janë parapa 100.000 euro, ku do të ndërtohen edhe çfar objekte faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- te kapacitetet e ujit e kemi parapa me I rrit kapacitetet e ujit në përpunim të ujit, pompat e të gjitha ato që shkojnë për at punë, të fushata

janë marr 100.000 euro i kemi kthi në stadion edhe i kemi hjek fushat nëpër fshatra këtë vit i kemi katër fusha, sepse edhe në fusha edhe nëpër shkolla nuk po ka kush me luft ma e ikemi lanë veç si kod viti tjetër nëse nuk gabo një vit i ka 20.000 viti tjetër 5.000 si kode i kemi lanë mos me i humb kodet këto fusha mujm me u dëmtu në forma të ndryshme edhe me mujt me investu në to nëse nuk jam nuk e keni ma për çdo vit 2024, 2025, 2026, 100.000 euro ose 120.000 fusha po i keni 270.000 vitin e parë stadion 320.000 në vitin 2025- 2026 sepse kur jemi taku me ministrin e Kulturës jemi dakordu me mbajt kodin unë të ndihmoj edhe besoj që edhe këtë vite po presim mos me shpall fazën e cila është me radh sepse ministri po shef se aka buxhet me na aloku për studion një milion ose sa të ka, ka thën jam I gatshëm me aloku faleminderit.

Hamit Haxhiu- unë pata një pyetje për Kryetarin, rruga kryesore që shko prej Poklekut realisht autostrada që lidhet për në Korrotic që vjen deri të feronikeli ku është faza a kur fillon të rregullohet qajo rruga kryesore. Edhe pyetja e dytë është rruga për të liqeni I Vasilevës para dy seancave më the që afatin për me rregullu kompania e ka deri me 30 Qershor po rast nevojë do ti merret edhe sigurimi, qka është ba me këtë kompani a do të vazhdojn punimet a qka është në pyetje aty.

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- rruga Kroni Mbretit- Feronikel ka fillu në viti 2014 unë e kom shty ka fillu I ka hy me bundozher arave maleve livadheve pa e shpall interes të përgjithshëm e si rezultat I asaj për ari tokë 2000 ose 2500 euro nuk e di sa është shuma më e madhe për ari tokë, nja 10 fish kemi pagu shpronësim më shumë se që ish dasht me kohë me I ndjek procedurat sigurisht është nën hëtim. Kompania e cila e ka marr në atë kohë sipas të gjitha gjasave nuk po ka kapacitet është në falimentim për qdo afat ligjor janë të detyrun mbikqyrat me I ba shkresa me ftu në vendin e punës, ajë po na shtynë procedurat interesi I jonë është më kry punën sepse I humbim të hollat që janë grand qeveritar edhe janë pjesë e Komunës. Sa I përket rrugës te Liqeni I Vasilevës nuk e di cila kompani, po ajo kompani I ka edhe disa rrugë nëpër Vasilevë e në Korrotic e cila nuk po I kryen janë punë që I kanë mare para pandemisë e kompanitë po gjejnë arsye janë rrit qmimet ne ju kem ofru edhe 20%-shin e asaj që e ka leju qeveria po nëse është grand qeveritar 20% ka me pagu Komuna edhe ata e kemi pranë me pagu veq me I kry unë me letra jam duke u provu me I kry e kam edhe rrugën te stadioni prej të premtës ka thën me I pru makinat po nuk po I bjen tash a po saboton se fitimin nuk e ka që mos me I kry ajë veq e dëmton qytetari mu nuk më bën gja se të hollat janë të taksapaguesve nuk janë të miat, pra këto projekte janë që I ka nis e nuk po I kryen po edhe projekte tjera edhe kompani tjera po edhe kompanitë tjera nuk po I kryen projektet kurrë nuk e di a po sabotojnë apo vërtet janë rrit çmimet edhe nuk po kanë leverdi me I kry punët zyra e prokurimit duhet me ja marr garancionin nëse se kryen punën ama ti dhëm afat edhe pak, e zamë që vonohet në dinamik të punës po interesi I jonë është me kry punë faleminderit.

Mehedin Salihu- kam një pyetje për Drejtorin e Infrastrukturës e di Drejtor që je I ngarkun po stafi I jot mundët me I kthi imellat sepse kam ankesa që nuk po ju përgjigjesh në imella njerëzve, pyetja e dytë qdo kun në listat e investimeve ekziston fshati Shtutic cilin dush project e merr në të gjitha vitet në vijim gjithëmon ekziston fshati Shtuticë që dy vite nuk ka asnjë investim pyetja ime ma konkrete është kur don me qit ndonjë foto në fshatin Shtutic te shoh edhe unë fshatin Shtuticë tuj investu të krenohem edhe unë faleminderit.

Arbër Halilaj- kam një pyetje shumë të rëndësishme për mua, për asamblen edhe për të gjithë qytetarët me 18.06.2023 ka ndodh një kociq që unë e quaja në Lumin Drenica kemi postu në rrjetet sociale ku me fillimin e punimeve në feronikel është bërë derdhje e mazutit në

mënyrë të pa kontrolluar ka qen avari apo qka ka qen nuk është me rëndësi unë menjëherë e kam ngrit si qështje në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsiror kan ardh të nesërmën dhe kur kan ardh ka dal që ka tejkalime të vlerave të lejume desha të ju njoftoj që pas një kohe të stërzgjatur për qasje në dokumente publike sipas ligjit pasi I kam me fakte që nëse nuk më vjen raport ose informatë do ti drejtohem zyrës së avokatit të popullit mbram I kam marr këto dokumente të kërkuara dotëthot raportin ku konstatohen shkeljet, aktvendimin ku së pari urdhërohet feronikeli që mos të bëj shkarkimin e ujrave që dalin nga procesi teknologjisë deri sat ë paiset me leje ujore domethënë nuk kanë pas as leje ujore dhe e fundit është ndëshkimi me gjobë për këtë veprim në shumën prej 10.000 euro ndaj operatorit kjo do të thot kur ka bashkëpunim dhe informim të qytetarëve në raport me ne si asamblistë mund të denoncojmë dukuri të tilla edhe tjera që ndodhin në mjedisin ton sepse dëmtimi I mjedisit jetësor e afekton njeriun, shtazët, florën e faunën e lumit Drenica në këtë rast, kështu që nga këtu I ftoj qytetarët që kurdo që kan informata për dukurit të këtilla të na informojnë dhe së bashku ti ndjekim deri në fund këto, Faleminderit.

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- iu drejtua Arbër Halilaj se kurfar informate nuk u kan Feronikeli publikisht e ka pranë defektin ose avarinë që e ka pas edhe ministria e mbikqyr e kontrollon jo ne ja kom spjegu edhe ty edhe kryetarit të subjektit tan se Ministria I jep lejet ambientale ajo I kontrollon ne vetem mundmi me dërgu ankesa, për qdo ditë një fabric e përpunimit të akumulatorëve e shkrirjes së akumulatorëve të elementeve kimike të barnave bën ndotjen dhjetëfish ma të madhe se feronikeli te Kroni I Mbretit në Sankoc nuk ka dit që kaloj e nuk e shoh I del tym jo prej tymtarit po krejt objektit shumë here kom dash me I thirr policing kom mendu që u djeg objekti kurrë njëherë nuk e ngritni zanin qeveris ja adresojnë e po presim përgjigje, Arbër kurr nuk e ken grit zërin për damin e madhë ambiental që la bëjnë automjetet, një pik vaj në tok I helmon 1 milion pika ujë I kemi mbi 60 varreza që janë përgjesi e Qeveris e Ministrisë përkatëse kur I kom shkru I kom detyru ata me dal edhe mi marrë masat edhe kom shku te qdo operator I kan than kryetari I juaj n aka than me dal se ne nuk ishim dal domethënë nuk kanë interes me ndal këtë gjë unë kam interes luftoj ma shumë se bëj llafe, qoj letra për qdo dit. Ky raport që na tregove u kan në të gjitha mediat edhe kemi diskutu në mbledhje këtu, Faleminderit.

Arbër Halilaj- nuk e kuptova repliken sepse nuk pat arsye, unë prite që ka mu mirëprit ky reagim I joni si Green për Drenas nuk di qka ka ba Komuna në këtë drejtim at ditë nuk e marr lejen prej Komunës me ju drejtu institucioneve qendrore domethënë nuk e din a jam anëku a jo për qështje tjera sepse nuk marr aprovi a jo, te feronikeli komu anks a her të ka ksi aksidente ose ekocid mjedisor I pëlqej apo jo dikuj kome përball Ministrinë qdo institucion me përgjegjësi kome kërku informata nga qytetarët sikur qdo qytetari që rastësisht ka dal domethënë I bjen që nëse se kishim pas informatën prej këtij kush kish reagu, kjo është pjes programore e jona edhe ty të sugjeroj qe kurdo që ki informata sikur këtu që I ceke lirisht mi drejtoni edhe unë vazhdoj tutje nuk marr aprovim prej juve prej kujtdo qoft që me ju drejtu një X ministrie te caktune ju kom drejtu edhe ministrive tjera veq për qështje mjedisore edhe do të ju drejtohem vazhdimisht kurdo që ka keqpërdorime e vërteta dhemb shkurt po gënjeshtro dhemb përherë faleminderit për përkrahjen.

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- Para se mu ba publike unë I kom qu inspektorat në Feronikel janë raportet edhe qytetari e din as se kom mbrojt as se mbron kush Feronikelin e mbrojm veq kur kemi obligim ligjor qysh I kemi mbrojt për pronat që ligjërisht janë në emër të ti, I kemi mbrojt edhe pronat tjera që kan than se ju ka ndal njerëzve punën se e ka fitu gjyqin krejt I kom rrëzu I kom qu parapërgjegjesis për falsifikim dokumenteve, e tash ata nja 20 vite kanë me u mundu me I prodhu dokumenta të ri për me dëshmu të kundërtën se

shkojnë në përgjesi. Kurrë se keni ngrit qështjen edhe që i ka gjujt peshqit e ngordht në Komoran të Lumi unë I kom qu, kurr nuk i ngritin qështjet ku I kallin gomat kam vështirësi me polici tuj rujt e duke u mundu mi gjet e dini që ambientin ato e shkatërrojnë. Ambienti në Feronikel jam ma shumë se ju me rujt sepse janë më afër qati ambienti po jo me rreh gjoks se nuk fiton kurgja sepse po flet për 18.06 sot jemi me 31.08 u kry kjo tem është njëjt sikur KTV-ja në Kohen e zgjedhjeve kur e ka pru një storje që e ka pagu dikush ti e din kush e ka pagu me than që kan vdek njerzit ktu prej ndotjes së feronikelit 2021- ten po ma qet mu ndërkoh që kishin vdek 1997 2022 njerzit pa as një konstatim mjeksor që kan vdek prej ndotjes së ambientit, deri në ksi suate I keni bo storjet televizive për mem muj mu faleminderit.

Egzona Tërdevci- unë i kam 3 qështje e para e falënderoj Drejtorin e Infrastrukturës Lokale Z. Endrit Gllareva që pas dy viteve insistim mu zotu që publikisht rruga në Gllabar lagja Tërdevci nis në Tetor.

qështja tjetër është një pyetje që ma ka drejtu një fermer nëse ka Komuna e Drenasit marrëveshje me Iber Lepenc rreth ujitjes së tokave, unë nuk jam njohës e qështjes po javë adresoj si pyetje si dhe qështja tjetër është zgjerimi dhe ndërtimi I sheshit në Drenas ju keni ba shumë presjon që me kalu shpejt aj project për shkak se jeni arsyeu se koha e fundit për me përfundu projekti është data 31.12.2023 pra mjetet e zotune prej MAPL-së, sa kam pa nga e prokurimi kam pa që kjo qështje është në OSHP ka dal I pari, për disa arsye teknike që si ka plotësu dhe në bazë të asaj që po flasin njerëzit I dyti është pikërisht aj që e kemi thanë që I merr krejt tenderët në Komunën e Drenasit po më intereson a janë respektu afatet ligjore dhe ku është qështja aktuale kur ka me fillu projekti I sheshit a është e mundur teknikisht që me u shpenzu mjetet që janë të zotune prej MAPL-së deri në fund të Dhjetorit, Faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- për projektin në Gllogar është Project që ne e kemi paraparë e ne e zhvillojmë a fillojmë në Shtator a tutje varet prej asaj pikës së tret që e ceke ti. sa I përket fermerit jemi nxan me ujësjellësin kemi pas nuk kemi ma domethënë për shkak se nuk kemi pas mjete se po I qojm veq aty e nuk po mundemi me i subvencionu po do ta shohim mundësin në vitin e ardhshëm a mundem me subvencionu sepse ne duhet me pagu Iber Lepencin edhe ata e bëjn një pages e bëjnë më 50 me 50 pa peticipimin e fermerit. Sa I përket sheshit tash dy kompani ose dy koserciume kan konkuru, zyra e prokurimit I ka shkrujt 3 here KRPP-së për me na e mundësu ata që po ja mundëson Qeveris 80% të projekteve të madhja me I zhvillu me negocim dhe nuk ma ka leju, a ka ban mirë se kishi mujt me than jadha këti apo ati me negocim tenderi u kan public për krejt kompanit edhe kompanitë të cilat plotësu kriteret dotë eliminohen sigurisht sepse edhe eksperti e ka dhanë vlerësimin, nuk është Feri nuk është mirë me permend pa kan ligjerisht është dikush tjetër, unë po pres me ma kthy OSHP- ja përgjigjen me ja kthy zyrës së prokurimit edhe me fillu me procedura, qka janë procedurat me fillu me shpenzu bugjetin Grandin qeveritar I cili është I përcaktun në qoft në qoft se nuk e shpenzojm deri me 24 Dhjetor nëse nuk po gaboju me dat ne e humbiom atë pjes që nuk shpenzohet e grandit e duhet me kumpeizu prej Komunës qaj është synimi im I pari, Egzona me mujt sheshin e boj për një vitë kemi me u mundu me kry sa ma shpejt presim me naj dhën dritën e gjelbër OSHP-ja edhe ne me vendos me ba nënshkrimin e Kontratës me fillu me punimet edhe me fillu me shpenzu buxhetin sepse e kemi detyrim nëse nuk e shpenzon unë edhe me dasht në vitin tjetër nuk muj me marr pjes në grand të performancës.

Egzona Tërdevci- e dim që ki dëshir me padit vazhdimisht po Drenasi është qytet I vogël njerzit jetojn këtu edhe e din që kompanit ktu nuk e kan vetem një kompani po kan edhe kompani tjera jan të lidhne nuk po shpifi kurgjo, kompania e cila ka dal me qmim ma të lirë

ekonomik po që nuk I ka plotësu kriteret tjera është njëra ndër kompanit që e përmende kështu që jam e gatshme me I bart edhe pasojat nuk jam tuj shpif asgjë.

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- ne flasim për operator pa emra këto kompani janë të regjistrueme në databaz edhe e kan një numër fiscal edhe kan një emër ose 10 emra të pronarëve të një kompanie pra po thom kanë qen dy konserciume që kan konkuru janm tepër I lumtur sepse zhvillimi I procedurave është më I shpejt nga ana e OSHP-së se me pas kan 10 a 20 e ma pas qu krejt në OSHP ish shku një koh deri të ishin zhvillu procedurat, sa I përket asaj padie nuk kom koh me u shty me dikom me demantu shpifjet sepse merr kohë unë nuk mirrem me atë gja sepse ligji ma lejon me vertetu në Gjykatë faleminderit

Beqir Kiqina- Kisha dasht me ngrit një shqetësim timin I cili është shumë evident e aq sa I përket Kuvendit Komunal, ekzekutivit e të gjith atyre I kisha ba një kërkes Drejtoris së Urbanizmit, Shërbimeve Publike po edhe Komitetit për Siguri në Bashkësi shqetësimi konkret është rruga Ilaz Kodra e cila është bukur të mira dhe është njëra ndër rrugët që frekuentohen edhe bizneset është duke u shëndërru në një rrugë për gar automobilistike I kom lajmru edhe policin e Komunës së Drenasit edhe I kom ba një kërkesë, kisha dasht që komiteti KKSB me trajtu sa ma parë me marrë masa me ftu edhe komandantin e policisë ose personat kompetent unë personalisht jam shumë I shqetsum aty mbi 100 h janë duke vozit njerzit sa ma parë me marrë masa edhe ata persona të cilët bëjn kësi veprime kriminale dhe vozitin me një shpejtësi të madhe me dal para ligjit dhe publikisht si anëtar I kuvendit komunal I baj thirrje edhe policis që të jen sa ma shum vigjilent me dal pas kërkesave të pa rreshtura përsëri persona të pa ndërgjegjshëm janë duke vozit me shpejtesi marramendse, nuk është ajo rrugë për me ba gara autompbilistike kështu që edhe një her edhe drejtorive përkatëse edhe komitetit kërkes që të mbajn një mbledhje sa ma par në qoft pse jo edhe të jashtëzakonshme dhe ta trajtoj me urgjenc sepse kur ndodh një rast atëher nuk ja vlen barra qiras.

Kryetari I Komunes Ramiz Lladrovci- I kemi ngrit këto shqetësime te policia ata kan kërku prej neve me I ble disa radar static me blic që me I vendos, ne po e shqyrtojm atë mundësi nuke di e kemi diskutu edhe në kuadër të drejtoris shumë shpejt do ti vendosim edhe kamerat e siguris se nuk është kurgjo veq me I pa ata po edhe me I siguru krejt automjetet edhe njerëzit që qarkullojn po nuk ka përfundu ende krejt puna.

Drin Halilaj- edhe unë sikur kolegu Beqir Kiqina kam një pyetje për të njejtën rrugë z. Gllareva a është parapa me u vendos vendkalim për këmbësor në atë rrugë?

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci - Nëse më lëjohet me u përgjigj do të vendosen krejt vijat ta bëjm me 3 traka edhe do ta vendosim shiritin e biciklistave jo vetem aty po qdo kund ku kemi mundësi patjetër që do ti qesim ne jemi duke punu edhe do të punojm edhe te sheshi ose parking I banesave që është tek blloku I kuq do ta bëjm krejt asfalt e pastaj do ti ndajm me vendparkingje edhe do ta lidhm edhe vendosim vijat, sepse kui janë vijat është nöse e godet dikush përgjesia është e shoferit

Hamit Haxhiu- Drejtorit I kërkoj që të mi jep qito përgjigje për qët rrugën e feronikelit se u ndërpre pak më herët edhe tek rruga Vasilev Liqeni deri kur do të filloj dhe të përfundojn besoj planin dinamik e ki

Drejtori I Infrastrukturës Endrit Gllareva- kryetaru=I e sqaroj shumë mir te rruga në Vasilev u zgjat sigurimi ja kemi dhën një mundësi kompanis besoj deri në vund të vitit e ka me përfundu atë rrugë ndërsa rruga Kroni I Mbretit Feronikelit është memorandum bashk me

Ministrin e Infrastruktues edhe ka afat ligjor deri në vitin 2025 edhe e kemi shkëput kontraten e urës se u deklarë se nuk mundet me krye jemi në procedura me zhvillu me e krye edhe ata na e ka miratu Ministria jemi në zhvillim të projektit të urës.

Mergim Pirraku – e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit meqë drejtori nuk është këtu mundet me u përgjigj dikush tjetër, nesër është 1 Shtatori dhe fillon mësimi diqka shumë e rëndësishme për ne mirëpo unë po shoh që tek dje e kemi shpall një konkurs për mësimdhënëse nuk është me rëndësi ku e dim që ne vitet e kalime kemi pas shumë humbje të orëve unë nuk muaj me I verifiku ato mirëpo kemi pas ankesa nga qytetarë përshembull në Qikatovë të Re ka qenë vendi I punës dikun 4 muaj për një land që kanë humb shumë orë ju kisha lutë me rregullu këtë problem sepse humbja e orëve për nxënësit është shumë tragjike, unë nuk po di pse duhet me ardh 1 Shtatori dhe ne ende mios me mujt me u përgadit që me funksionu mësimi taman si duhet nëse e kam gabim kërkoj falje mirëpo këto I kam informatat.

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- nëse e ki fjalën nëse nuk gabo për Gjuhë Gjermane është përserit konkursi sepse një aplikant që nuk mund e kalon testin 29 pikë ose me 39 pikë most ë flas 50 pikë duhet me i pas për me kalu për me thirr me gojë duhet me përserit konkursin se nuk guxojm me marr veq se ka apliku dikush në qoft se është fjala për këtë konkurs, me kanë me leju Ministries e me ba listen për këtë landë ose për këtë tem ka me ardh i dyti i treti na kurr nuk kishim pas problem por nuk mundet me mbet 3 muaj pa mësimdhënëse sepse e kemi oblogim me dërgu një muaj dikan me njëher aplikant të fushës e pastaj me i vazhdu procedurat në qoftë se ka ankesa normal që ne nuk mundemi me marr dikand gjatë procesit të ankesave.


Megrim Pirraku –unë po flas si fenomen nuk po lidhem me ndonjë rast të caktuar unë nuk po kuptoj pse duhet me ardh 1 Shtatori edhe pse me hap konkurs në Gusht pse nuk po realizohen intervistat konkurset në Qershor ose ma herët kur të përfundon mësimi edhe me shfrytëzu kohën se nëse ne hapim konkurs me 31 Gusht sigurisht që ajo do të marrë kohë edhe disa orë do të humbin, nëse humbet një orë ajo për mu është tragjike.


Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Dje keni pas rast kërkesat për pushim pa pages një vjeçare, nëse ata e kanë ba kërkesën e ne ja aprovojmë dikuj e dikuj nuk ja kemi aprovu për shkak se ka pas sqarimin e mjaftueshëm ati duhet me ja zhvillu konkursin po nuk ka dikush që u kanë para 3 muaj që u kanë i lir vendi edhe e kemi zhvillu konkursin tash ose e kemi hap tash nuk domethan , na i kemi zhvillu procedurat na kanë mbet ata që nuk janë kanë adekuat ose ata që nuk e kanë kalu testin edhe është konkursi i dytë .

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 12:40 min.


Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 31.08.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi

Indria Olluri Thaqi 



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E DRENASIT

ZYRA E KRYETARIT

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	15 09 2023		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01. 400/03-	46/72		



PROPOZIM VENDIMI I BUXHETI TË KOMUNËS PËR VITIN 2024 DHE PARASHIKIMI I BUXHETIT 2025 - 2026

Drenas, gusht 2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në vështrim të nenit 12 dhe 40 pika 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 61 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 34 pika 34.6 nën (b) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë _____ vitit 2023 të aprovoi këtë:

**PROPOZIM VENDIM
I BUXHETIT TE KOMUNËS PËR VITIN 2024 DHE PARASHIKIMI I
BUXHETIT PËR VITET 2025- 2026**

Neni 1

Më këtë propozohet, Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2024 si dhe parashikimi i buxhetit për vitet 2025-2026.

Drafti I Buxhetit për vitin 2024 miratohet në shumë prej: **20,968,992** euro, si dhe parashikimi i Buxhetit ,

- Për vitin 2025 në shumë prej: **22,055,885.70** euro dhe
- Për vitin 2026 në shumë prej: **23,140,465** euro.

Neni 2

Të hyrat e Buxhetit të Komunës, planifikohen të realizohen nga dy burime:

- Grantet e Qeverisë dhe nga
- TëhyratVetanake .

Komuna gjatë viteve në vijim, mund të realizoi mjete nga donacionet dhe participimi i qytetarve dhe huamarrja. Mjetet nga donacionet, participimi dhe huamarrja, do të jenë pjesë të këtij buxheti dhe do ndikojnë në rritjen e buxhetit, varësisht nga viti që do të ndodhë. Rritja e buxhetit do të bëhet, vetëm kur mjetet të paguhen në xhirollogarinë e komunës.

Neni 3

Të hyrat e buxhetit të komunës planifikohet të realizohën si vijon:

	Të hyrat sipas Sektorëve	2024	2025	2026
1	Spektori i Përgjithshëm	10,234,624	10,941,822	11,635,577
2	Spektori I Arsimit	7,870,632	8,106,940.70	8,349,309
3	Spektori I Shëndetësisë	2,863,736	3,007,123	3,155,579
	Gjithsej:	20,968,992	22,055,885.70	23,140,465

Neni 4

Shpenzimet për vitet 2024-2026 aprovohen për 20 programe – nënprograme buxhetore në nivel komunal, dhe në pesë (5) kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve si vijon:

Buxheti për vitin 2024

Programet:	Paga dhe Mëdit.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Zyra kryetarit	179,974	100,622		8,000		288,596
D.Administrates	262,960	162,700				425,660
D.Inspekcionit	78,845	63,050				141,895
Zyra e Kuvendit	257,838	22,200				280,038
D.Buxh.e Finan.	112,314	18,450				130,764
D.Sh.Pub.Inf	184,362	326,490	191,700	100,000	113,656	916,208
D.Infrastr.Publi	55,424	47,000			5,066,804	5,169,228
Z.Kom. dhe Kth	10,300	550				10,416
D.Bujq.zh.rural	92,869	41,499		60,000		194,368
D.Gjeod.kad.	91,038	10,150				101,188
D.Plan.Urban	57,896	66,150			58,000	182,046
D.Zhvill ekon.	57,592	41,970		60,000		159,562
D.Kultur Rini s	87,226	125,785		135,000	315,000	663,011
Admin Shendet	44,452	8,140		30,000		82,592
QPS	109,530	40,380	9,200		290,000	449,110
Adm.Arsim	93,508	305,178		100,000		498,686
QKMF	1,926,839	882,897	54,000		170,822	3,034,558
Arsimi parafillor	207,075	47,000	6,549			260,624
Arsimi fillor	5,634,747	314,617	65,000		370,000	6,384,364
Arsimi i Mesem	1,487,038	86,606	22,000			1,595,644
Gjithsej	11,031,827	2,711,434	348,449	493,000	6,384,282	20,968,558

Buxheti për vitin 2025

Programet:	Paga dhe Mëdit.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Zyra kryetarit	180,514	63,000		9,000		252,514
D.Administrates	263,749	141,213				404,962
D.Inspekcionit	79,104	47,700				126,804
Zyra e Kuvendit	258,611	22,200				280,811
D.Buxh.e Finan.	112,651	18,450				131,101
D.Sh.Pub.Inf	184,902	286,927	217,137	100,000	97,769	886,735
D.Infrastr.Publi	55,590	35,000			5,880,103	5,970,693
Z.Kom. dhe Kth	10,323	760				11,083
D.Bujq.zh.rural	93,148	41,399		75,000		209,547
D.Gjeod.kad.	91,311	10,150				101,461
D.Plan.Urban	58,070	76,150			58,000	192,220
D.Zhvill ekon.	57,765	32,230		65,000		154,995
D.Kultur Rini s	87,488	121,685		135,000	335,000	679,173
Admin Shendet	44,585	3,840		30,000		78,425
QPS	109,859	40,380	9,200		200,000	359,439
Ad.Arsim	93,789	403,751		123,370		620,910
QKMF	1,932,620	726,370	54,000		294,133	3,007,123
Arsimi parafillor	207,696	49,773	6,549			264,018
Arsimi fillor	5,651,651	474,099	65,000		468,018	6,658,768
Arsimi i Mesem	1,491,499	151,606	22,000			1,665,105
Gjithsej	11,064,923	2,746,683	373,886	537,370	7,333,023	22,055,885

Buxheti për vitin 2026

Programet:	Paga dhe Mëdit.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Zyra kryetarit	181,056	65,400		9,000		255,456
D.Administrates	264,540	151,700				416,240
D.Inspekcionit	79,363	47,700				127,063
Zyra e Kuvendit	259,385	22,200				281,585
D.Buxh.e Finan	112,989	18,450				131,439
D.Sh.Pub.Inf	185,444	348,621	196,410	120,000	90,000	940,475
D.Infrastr.Publi	55,757	31,000			6,192,121	6,278,878
Z.Kom. dhe Kth	10,346	600				10,946
D.Bujq.zh.rural	93,427	41,499		80,000		214,926
D.Gjeod.kad.	91,585	10,150				101,735
D.Plan.Urban	58,244	76,150			51,591	185,985
D.Zhvill ekon.	57,938	31,440		70,000		159,378
D.Kultur Rini s	87,750	83,685		160,612	334,000	666,047
Admin Shendet	44,719	3,840		30,000		78,559
QPS	110,188	40,380	9,200		200,000	359,768
Ad.Arsim	94,070	283,025		100,000		477,095
QKMF	1,938,417	780,142	81,029		355,992	3,155,580
Arsimi parafillor	208,319	55,420	8,549			272,288
Arsimi fillor	5,668,607	478,433	75,000		1,030,000	7,252,040
Arsimi i Mes.	1,495,974	251,008	28,000			1,774,982
Gjithsej	11,098,118	2,820,843	398,188	569,612	8,253,704	23,140,465

Neni 5

Shpenzimet për paga dhe mëditje të përcaktuara më këtë draft do të shpenzohen për pagimin e stafit të tre Sektorëve kryesor të komunës. Në programet dhe nënprogramet buxhetore janë lejuar të financohen **1365** punëtor dhe ky numër i financimit është i përcaktuar më Qarkorën Buxhetore 2024/01, lëshuar nga Ministri i Financave Punës dhe Transfereve.

Pagat e aprovuara të stafit më këtë vendim nuk mund të rriten gjatë vitit fiskal, me përjashtim të rritjes së lejuar me vendim të Qeverisë.

Neni 6

Shpenzimet për mallëra dhe shërbime dhe shpenzimet komunale për vitet 2024-2026, janë të planifikuara dhe aprovuara, sipas programeve-nënprogrameve buxhetore për plotësimin e nevojave gjatë viteve, por gjithnjë duke pasur parasysh mundësinë e kursimeve.

Neni 7

Mjetet e dedikuara për subvencione dhe transfere do të shpenzohen për projekte të ndryshme për të cilat programet dhe nënprogramet kanë paraqitë kërkesat e tyre, dhe do të shpenzohen në bazë të kriterëve të përcaktuara, dhe dispozitave ligjore dhe rregullave të përcaktuara nga Departamenti i thesarit –MFPT .

Neni 8

Shpenzimet për investime kapitale do të shpenzohen sipas projekteve të aprovuara nga kuvendi i komunës dhe kuvendi i Kosovës dhe të regjistruara në programin e PIP-it.

